



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.09.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2588/21, për zyrtarin e lartë z. Armend Muja, Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, duke dhënë dorëheqje nga pozita e Rektorit në Kolegjin “Riinvest”, dhe pozita e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Armend Muja, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), ex-officio ka hapur rastin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pasi që z. Muja si zyrtar i lartë, respektivisht, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht figuronte edhe si person i autorizuar në biznesin privat N.SH. “EMDI”, e që zyrtarisht (DPKI-06-2588/21) është konfirmuar edhe nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë. Gjithashtu, Agjencia ka gjetur se z. Muja mbante pozitën e rektorit në kolegjin privat “Riinvest”.

Agjencia, përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/1888/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, Agjencia ka kontaktuar me z. Muja dhe e ka njoftuar me faktet që posedon lidhur me mbajtjen e pozitave të



tjera krahas ushtrimit të funksionit publik, si dhe për papajtueshmëritë me ushtrimin e funksionit publik të cilat i parasheh Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me këtë rast, Agjencia e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksion menaxhuese apo atë të përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë, dhe ka premtuar se do të ndër marrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Me qëllim të sqarimeve e shtesë, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në zyrat e Agjencisë, me ç’rast i njëjti ka sjellë dëshmi për fillimin e procedurave lidhur me ndryshimet në biznes dhe është udhëzuar nga Agjencia për veprimet që duhet t’i ndër marrë edhe sa i përket pozitës së rektorit në Kolegjin “Riinvest”.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-02/1888-1/22) me dokumentet përcjellëse (informatat e biznesit dhe letër dorëheqja), në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndër marrë veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat N.SH. “EMDI”, si dhe nga pozita menaxhuese në Kolegjin “Riinvest”.

Me veprimet e ndër marra nga z. Muja, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit në lidhje me nenin 29 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


 Yll Buleshkaj
 Drejtor i Agjencisë për
 Parandalimin e Korrupsionit